

Drejtoria Arsimore e Filadelfias

Progres Raporti i Shkollës – Udhëzim për Prindin dhe Familjen



Çfarë kryen progres Raporti (SPR)?

Progres Raporti i Shkollës (SPR), është një mjet i krijuar çdo vit nga Drejtoria Arsimore e Filadelfias. Ai ofron informacion se si po vepron shkolla juaj në fushat, që kanë më shumë rëndësi për suksesin e nxënësve - **Arritjet** Mësimore dhe **Progresin, Klimën** e së Shkollës dhe Përgatitjet për **Kolegj** dhe **Punësim**. SPR na ndihmon të njohim:

- ✓ Cilat shkolla janë më mirë në fusha të ndryshme?
- ✓ Ku arrijnë fëmijët nivele më të larta?
- ✓ Cilat fusha në secilën shkollë duhet të ndryshohen, në mënyrë që të përmirësohen rezultatet e nxënësve?

Kategoritë e Shkollës sipas SPR

Shkollat mund të renditen nga 0-100%. Bazuar në vlerësimin e përgjithshëm, shkollat kategorizohen sipas katër kategorive të mëposhtme:



Kërkon Ndërhyrje
(0-24%)

Kërkon Ndërhyrje – Progresi në këtë nivel nuk është i pranueshëm. Këto shkolla kërkojnë vëmendje dhe asistencë të menjëherëshme.



Në Vrojtim
(25-49%)

Në Vrojtim – Shkollat e këtij niveli kanë bërë progres, por jo të mjaftueshëm. Këto shkolla duhet të vrojtohen e mbështeten me kujdes, që të vazhdojnë përmirësimin.



Në Përforcim
(50%-74%)

Në Përforcim – Shkollat e këtij niveli kanë treguar mjaft anë pozitive dhe me pak ndihmë duhen nxitur të vazhdojnë me planet dhe programet që po aplikojnë.



Model
(75-100%)

Model – Ky është niveli më i lartë që mund të arrijë një shkollë. Këto shkolla janë në mes më të mirave të qytetit.

Ky sistem vlerësimi mund të përdoret për të kuptuar se si po sillet shkolla juaj në çdo seksion, si dhe matjet e SPR.

Si vlerësohet shkolla ime në pikët e saj të SPR?

Saktësisht ajo që merret në konsideratë për vlerësimin e përgjithshëm të një shkolla, varet nga nxënësit që j'u shërbehet. P.sh pikët e përgjithëshme të një shkolle fillore, ose tetëvjeçare merren në konsideratë nga **Arritjet, Progresi, dhe Klima e Shkollës**, ndërsa pikët e SPR për shkollën e mesme përfshijnë edhe **Përgatitjet për Kolegj dhe Punësim**. Çdo fushë, ose seksion i SPR ka një peshe të ndryshme në vlerësimin e përgjithshëm të shkollës.



	Arritja	Progresi	Klima e Shkollës	Përgatitja për Kolegj & Punësim	Rezultati i përgjithshëm % e pikëve totale të mundshme
Shkollat fillore dhe tetëvjeçare	30%	40%	30%	Nuk aplikohet	100%
Shkollat e Mesme	30%	40%	20%	10%	100%

Vlerësimi i përgjithshëm tregon se si po ecën shkolla në raport me synimet e Drejtorisë Arsimore dhe mund të përdoret për të kuptuar ndryshimet e performancës me kalimin e kohës.

Kuptimi i Seksioneve të SPR

Arritja	Progresi	Klima e Shkollës	Përgatitja për Kolegj & Punësim
Ky seksion na tregon për arritjet e nxënësve në Lexim, Shkrim, Matematikë, Shkencë si edhe për nxënësit ELL aftësitë e tyre gjuhësore.	Ky seksion na tregon se si këto vlerësime lëvizin nga viti në vit në lexim/shkrim, matematikë dhe shkencë dhe se si nxënësit e shkollave të mesme janë në rrugën e diplomimit.	Shkollat duhet të jenë vende të sigurta dhe me mjedis ku nxënësit duan të mësojnë. Ky seksion na tregon për frekuentimin e nxënësit, përshtirjen e tyre dhe rezultatet e raporteve nga pyetësi i përvitshëm.	Ky seksion na tregon nëse nxënësit e shkollës së mesme janë duke u diplomuar, nëse ata janë duke u përgatitur për shkollën e lartë, ose për punësim (vetëm për shkollat e mesme).
Çfarë të dhënash vlerësohen nga SPR?			
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Arritja në PSSA/Keystone ✓ Arritja në ACCESS (për ELL) ✓ Leximi në Nivelin e Klasës 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Indeksi i Rritjes Mesatare (AGI) ✓ Rritja në ACCESS (për ELL) ✓ Përqindja e Nxënësve në drejtimin e caktuar ✓ Barazia 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Frekuentimi ✓ Dënimi në Shkollë ✓ Pezullimet ✓ Pyetësorët e Nxënësit dhe Prindit 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Diplomimi nga Shkolla e Mesme ✓ Regjistrimi në Kolegj ✓ Përgatitja për Kolegj/Punësim ✓ Pyetësorët e Nxënësit
Pse është kjo kaq e rëndësishme?			
<p>Leximi në nivelin e klasës të çon drejt suksesit në fushat e tjera mësimore.</p> <p>Arritjet më të herëshme të nxënësit ndikojnë në rastet e transferimeve dhe pranimeve në shkollën e mesme.</p> <p>Rezultatet e testeve ndikojnë në pranimin në kolegj (për nxënësit e shkollës së mesme).</p>	<p>Për nxënësit e prapambetur, rritja e dukëshme, është e nevojshme që të arrihet niveli i klasës.</p> <p>Ecuria me kredite të pa realizuara, mund të rrezikojë, që nxënësi të mos e përfundojë shkollën.</p>	<p>Një klimë shkolle e shëndetëshme është baza për mësimin e nxënësit.</p> <p>Nëse fëmijët nuk shkojnë në shkollë, ata nuk mund të mësojnë.</p> <p>Zërat e prindërve dhe nxënësve janë thelbësore për suksesin e shkollës.</p>	<p>Diplomimi nga shkolla e mesme rrit mundësitë për veprimtarinë e mëtejshme të nxënësve.</p> <p>Të diplomuarit nga shkolla e mesme, ndikojnë në shëndetin e një qyteti.</p> <p>Të diplomuarit me rezultate të larta, kanë ecuri më të mirë edhe në shkollë të lartë/punësim.</p>
Çfarë mund të bëni ju?			
<p>Mbështetni mësimin e nxënësit jashtë shkollës.</p> <p>Bëni kujdes me të dhënat e testeve, sigurohuni që nxënësit janë të përgatitur dhe i nxitni ata të synojnë më të mirën.</p> <p>Monitoroni performancën e nxënësit në çdo etapë dhe në dëftesat.</p> <p>Diskutoni përmbajtjen e lëndës me nxënësit dhe mësuesit e tyre.</p> <p>Punoni me shkollën dhe/ose Këshillin Konsultativ të Shkollës (SAC) për përmirësimin e arritjeve të nxënësit.</p>	<p>Merrni pjesë në pyetësin vjetor dhe i nxitni nxënësit të veprojnë njëjloj.</p> <p>Sigurohuni që nxënësit të mos mungojnë në shkollë më shumë se 1 ditë në muaj, me ose pa arsye</p> <p>Punoni me shkollën dhe/ose Këshillin Konsultativ të Shkollës (SAC) për përmirësimin e klimës së shkollës.</p>	<p>I regjistroni nxënësit që kanë nevojë në programet verore, ose për rivendosjen e krediteve.</p> <p>Rritni aksesin tuaj në programet që pasurojnë përgatitjen e nxënësve për kolegj dhe punësim.</p> <p>Theksoni rëndësinë e frekuentimit.</p> <p>I nxitni nxënësit të marrin pjesë në pyetësin e përvitshëm.</p>	

Burime Shtesë për SPR

Ueb-sajti i Progres Raportit të Shkollës (SPR), i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, përfshin edhe burime e informacione të tjera shtesë rreth SPR dhe çështjeve që ai trajton: <http://www.philasd.org/language/albanian/school-progress-report>.

Në këtë faqe, ju do të gjeni **Udhëzime Përdorimi të SPR, Pyetjet më të Shpeshta dhe Udhëzuesin e Familjes për SPR (e vlefshme në shumë gjuhë)**, si edhe **Regullat e Punës së SPR**, të cilat ofrojnë detaje se si llogaritet çdo gjë në SPR.

Të dhënat e Testimit dhe të Dhëna të Tjera të Rëndësishme

Rishikoni rregullisht Ueb-Kalendarin e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias për **datat e Testeve të ardhëshme, datave të regjistrimit dhe datave të tjera të rëndësishme** për nxënësin dhe shkollën tuaj: <http://www.philasd.org/language/albanian/calendar>.

Pyetësorët Vjetorë

Ne e dëshirojmë mendimin tuaj! **Plotësoni Pyetësorin Vjetor të Prindit & Kujdestarit**, ku do të na shprehni mendimet për shkollën tuaj dhe rrugët për përmirësimin e saj: <http://philasd.org/parentsurvey/index.php?lang=sq>.

Rishikoni **rezultatet e pyetësorit për shkollën tuaj** në uebsajtin e pyetësorëve të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias: schoolsurveys.philasd.org.

Përfshihuni dhe Mbështetni Përmirësimin e Shkollës



Vizitoni uebsajtin e Zyrës së Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit (FACE) për më shumë informacion se **si të mbështetni më mirë nxënësin dhe shkollën tuaj**:

<http://www.philasd.org/language/albanian>

Angazhohuni! Vlerësoni pjesëmarrjen në **Këshillin Konsultativ të Shkollës (SAC)** tuaj, që të ndihmoni mbështetjen e arritjeve mësimore, përmirësimin e klimës dhe kulturës së shkollës, dhe fuqizimin e angazhimit të familjes.